



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 128

Tiranë – E premte, 13 gusht 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Drejtësisë nr. 8, datë 30.7.2021	Për përcaktimin e rasteve, kushteve dhe mbrojtjes së veçantë në situata emergjente të punonjësve të Policisë së Burgjeve dhe drejtuesve të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale... 13371
Urdhër i Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 106, datë 10.8.2021	Për delegim kompetence..... 13372
Urdhër i drejtorit të përgjithshëm të Arkivave nr. 519, datë 11.8.2021	Për delegim kompetencash..... 13373
Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 12, datë 5.7.2021	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH..... 13373
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 3683/6, datë 10.8.2021	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Rikonstruksioni i rrugës ‘Koli Marku’, Patos”..... 13376

**UDHËZIM****Nr. 8, datë 30.7.2021****PËR PËRCAKTIMIN E RASTEVE,
KUSHTEVE DHE MBROJTJES SË
VEÇANTË NË SITUATA EMERGJENTE
TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË
BURGJEVE DHE DREJTUESVE TË
INSTITUCIONEVE TË EKZEKUTIMIT
TË VENDIMEVE PENALE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, dhe nenit 20, pika 4, të ligjit nr. 80/2020, “Për Policinë e Burgjeve”,

UDHËZOJ:

1. Punonjësit e Policisë së Burgjeve dhe drejtuesit e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale (këtu e në vijim “kërkuesi”), të cilëve për shkak të detyrës që kryejnë ose kanë kryer u rrezikohet jeta, familja apo prona nga veprime të paligjshme të të tretëve, kanë të drejtë t’u sigurohet mbrojtje e veçantë fizike nga Policia e Shtetit. Në situata emergjente, kur për shkak të natyrës dhe kompleksitetit të çështjes, është i pamundur garantimi i mbrojtjes nga Policia e Shtetit, ofrohet mbrojtje e veçantë nga struktura e posaçme e Policisë së Burgjeve, sipas rregullave dhe kushteve të përcaktuara në këtë udhëzim.

2. Në rastet kur punonjësi i Policisë së Burgjeve apo drejtuesi i institucionit ndodhen përballë një rreziku dhe situatë emergjente a komplekse për veten e tyre, familjen ose pasurinë, për shkak të detyrës që mbajnë apo që kanë kryer, i paraqet menjëherë kërkesë me shkrim ministrit të Drejtësisë.

3. Kërkesa drejtuar ministrit të Drejtësisë përmban gjeneralitetet e personit që i kanoset një rrezik apo, kur është rasti, të dhënat e pasurisë, institucionin ku personi punon, arsyet e rrezikut, rrethanat, llojin e rrezikut, si dhe kushtet e emergjencës apo të kompleksitetit të çështjes.

4. Konsiderohen si raste emergjence apo çështje komplekse, rastet kur:

a) punonjësi ndodhet në një situatë rreziku që mund të dëmtojë atë, familjen apo pasurinë në

një kohë relativisht të shkurtër, e cila nuk mund të presë për mbrojtjen e ofruar nga Policia e Shtetit.

b) punonjësi ndodhet në një gjendje kërcënimi konkrete dhe serioze, për shkak të së cilës, jeta, shëndeti, familja apo pasuria e tij mund të cenohen.

c) punonjësi ndodhet në një situatë që kërkon ndërmarrjen e veprimeve apo të masave menjëherë dhe pa vonesë për ta zgjidhur atë, si dhe për të shmangur çdo lloj dëmtimi.

5. Ministri i Drejtësisë vendos mbi sigurimin ose jo të mbrojtjes së veçantë menjëherë dhe, në çdo rast, jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë nga marrja e kërkesës. Urdhri i ministrit për sigurimin e mbrojtjes së veçantë i njoftohet menjëherë drejtorit të Policisë së Burgjeve, i cili siguron zbatimin e tij nga struktura e posaçme e Policisë së Burgjeve.

6. Urdhri i ministrit të Drejtësisë, kur vendos pranimin e kërkesës, përveç elementeve të përcaktuara në nenet 99 dhe 100 të Kodit të Procedurës Administrative, përmban edhe:

a) urdhërimin për sigurimin e mbrojtjes së veçantë të kërkuesit;

b) kohëzgjatjen e masës mbrojtëse;

c) periudhën e raportimit për gjendjen e kërcënimit;

ç) kontrollin periodik të kushteve që diktojnë mbrojtjen;

d) strukturën që ekzekuton masën mbrojtëse.

7. Kur diktohet nga natyra e çështjes, Ministria e Drejtësisë e përcjell urdhrin elektronikisht pranë drejtorit të Policisë së Burgjeve apo strukturës së posaçme në Policinë e Burgjeve.

8. Në rastet kur ministri i Drejtësisë vendos kërkuesin në mbrojtje të veçantë, kërkuesi i dorëzon ministrit të Drejtësisë, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e urdhrin për vendosjen në mbrojtje të veçantë, dokumentacion shtesë, me qëllim verifikimin e rrezikut që i kanoset dhe situatën e emergjencës apo të kompleksitetit të çështjes. Ministri i Drejtësisë mund të kërkojë informacion edhe kryesisht.

9. Kërkuesi mund të paraqesë dëshmi, deklarime, akte procedurale apo informacione të dokumentuara, të cilat provojnë kushtet e nevojës për mbrojtje.



10. Sipas rastit, ministri i Drejtësisë vendos, brenda 10 (dhjetë) ditëve, ndryshimin, revokimin apo përfundimin e masës mbrojtëse.

11. Kundër urdhrit të ministrit të Drejtësisë për mospranim të kërkesës për mbrojtje të veçantë, si dhe kundër urdhrit për ndryshimin apo revokimit, kërkuesi mund të paraqesë ankim në gjykatën kompetente, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Administrative, si dhe legjislacionit në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

12. Kur ministri i Drejtësisë urdhëron mbrojtjen e veçantë, struktura e posaçme e Policisë së Burgjeve kryen verifikimin e dokumentacionit identifikues dhe vendos menjëherë nën mbrojtje punonjësën e Policisë së Burgjeve, drejtuesin e institucionit, familjen apo pasurinë e tij.

13. Mbrojtja e veçantë konsiston, në:

a) ruajtjen apo shoqërimin fizik të personit të rrezikuar;

b) ruajtjen e familjarëve, banesës apo pasurisë së personit të rrezikuar.

14. Masat mbrojtëse vendosen me afat deri në 3 (tre) muaj dhe me të drejtë shtyrjeje afati jo më shumë se 1 (një) muaj. Kohëzgjatja e masave mbrojtëse vazhdon deri në largimin e kushteve dhe të rrethanave për të cilat është vendosur mbrojtja.

15. Struktura e posaçme e Policisë së Burgjeve është përgjegjëse për marrjen e masave për ekzekutimin e urdhrit të ministrit të Drejtësisë, mbi ruajtjen fizike apo edhe masa të tjera, sipas përcaktimeve të bëra në urdhër.

16. Përveç detyrave të përcaktuara në procedurat standarde të Policisë së Burgjeve, struktura e posaçme e Policisë së Burgjeve, ka për detyrë:

a) të informojë me shkrim çdo 2 (dy) javë ose më shpesh, si rrethanat e rastit e diktojnë, mbi ecurinë e masave mbrojtëse për personin e rrezikuar. Ky informacion i përcillet drejtorit të Policisë së Burgjeve dhe ministrit të Drejtësisë;

b) të njoftojë strukturat eprorë për rastet e situatave të rrezikut emergjent, për personin e mbrojtur, që mund të lindin gjatë shërbimit ditor;

c) në rastet kur personi i mbrojtur, krijon vështirësi apo pamundëson garantimin e mbrojtjes nga struktura e posaçme, njofton

menjëherë me shkrim drejtorin e Policisë së Burgjeve dhe ministrin e Drejtësisë.

17. Krahas marrjes së masave mbrojtëse, punonjësit e strukturës së posaçme të Policisë së Burgjeve bashkëpunojnë me Policinë e Shtetit dhe institucionet e tjera për marrjen në vazhdimësi të informacioneve në funksion të parandalimit të ngjarjeve të mundshme kriminale, në drejtim të personit të mbrojtur, familjes, banesës apo pasurisë së tij.

18. Në rastet kur personi i kërcënuar punon në një rreth apo qark dhe familja e tij banon në një tjetër, masat urgjente mbrojtëse merren sipas nevojës për të dhe për familjen, në funksion të mbrojtjes dhe në varësi të intensitetit që ka kërcënimin.

19. Strukturat e posaçme të Policisë së Burgjeve, për zbatimin e masave urgjente mbrojtëse, hartojnë plane masash të veçanta mbi gjendjen e rrezikut dhe eliminimin e tij.

20. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

URDHËR
Nr. 106, datë 10.8.2021

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje dhe në zbatim të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; si dhe të VKM-së nr. 395, datë 13.5.2020, “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin, drejtorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, znj. Klodiana Guci.

2. Kompetencat e titullarit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin do të ushtrohen për



periudhën nga data 12.8.2021 deri më datë 19.8.2021.

3. Nuk delegohen kompetenca të padelegueshme të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet drejtori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, znj. Klodiana Guci.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
I AGJENCISË SHTETËRORE
PËR SHPRONËSIMIN
Erlis Hereni

URDHËR
Nr. 519, datë 11.8.2021

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 11/b, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 11, pikave 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të drejtorit të përgjithshëm të Arkivave, z. Endrit Musaj, drejtor i Inspektimit dhe Trajnimeve, për shkak të mungesës me arsye të titullarit të këtij institucioni.

2. Delegimin e kompetencave për firmosjen e kërkesave social/juridike të qytetarëve dhe institucioneve.

3. Kompetencat e drejtorit të përgjithshëm të Arkivave dhe të drejtorit të Evidencës Qendrore dhe Komunikimit, do të ushtrohen për periudhën nga data 12.8.2021 deri në datën 13.8.2021.

4. Nuk delegohen kompetencat e drejtuesit lidhur me personelin, si dhe kompetencat e tjera të padelegueshme, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

5. Për veprimet e kryera në zbatim të këtij urdhri, drejtori i Inspektimit dhe Trajnimeve do

të ruajë kopje të kartelave shoqëruese të praktikave shkresore të iniciuara apo të përfunduara prej tij, së bashku me afatet e përcaktuara dhe ecurinë e mbarëvajtjen e çështjeve dhe do t’ia bëjë të ditura titullarit me rikthimin e tij në detyrë.

6. Për zbatimin e urdhrit ngarkohet drejtori i Inspektimit dhe Trajnimeve z. Endrit Musaj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH Nr. 12, datë 5.7.2021

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, të ndryshuar, kreu III, neni 13, pika “b”), në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘sekret shtetëror’”, kreu II, neni 4, pika “a”, “c” dhe në udhëzimin nr. 99, datë 13.4.2018, “Për zbatimin e vendimit nr. 662, datë 15.11.2017, për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhër nr. 13, datë 3.5.2018 të kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘sekret shtetëror’”, i ndryshuar në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, me vendimin nr. 12, datë 5.7.2021 si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtëm:

1. Dosje nr. 278, “Relacion i ministrit të Punëve të Brendshme mbi veprimtarinë e organizatës armiqësore të kryesuar nga **T.S., T.D.** etj.”, me 22 (njëzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit nr. 4, Drejtoria I, viti 1961.

2. Dosje nr. 217, “Për disa shqetësime në Kombinatin Kimiko-Metalurgjik në Laç, si dhe në Minierën e bakrit Spaç”, me 9 (nëntë) fletë.



Niveli i klasifikimit është “Sekret”. Dosja i përket Fondit nr. 4, Drejtoria I, viti 1988.

3. Dosje nr. 81, “Buletine mbi komentet dhe parrulla elementët armiq rreth gjyqit të komplotistëve dhe situatës aktuale në vendin tonë”, me 43 (dyzet e tre) fletë. Niveli i klasifikimit është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit nr. 4, Drejtoria I, Viti 1961.

4. Dosje nr. 125, “Informacion i Drejtorisë I, për komente të diplomatëve grekë për Kongresin e Lidhjes së Shkrimtarëve e Artistëve të Shqipërisë dhe marrëdhëniet e Shqipërisë me Greqinë, Italinë e Gjermaninë”, me 3 (tri) fletë. Niveli i klasifikimit është “Sekret”. Dosja i përket Fondit nr. 4, Drejtoria I, viti 1984.

5. Dosje nr. 7, “Relacion për kapjen e një diversanti dhe procesverbale të ndryshme për gjetje materiale të ndryshme të diversantëve të vdekur e të kapur”, me 9 (nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit nr. 4, drejtoria I, viti 1953.

6. Fashikull nr. 2121, në ngarkim të **H.M. dhe R.P.**, me 77 (shtatëdhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Të Huajt.

7. Dosje formulare nr. 718/41, në ngarkim të **Z.Ll.**, me 22 (njëzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Të arratisur.

8. Fashikull nr. 336, në ngarkim të **A.L.**, me 43 (dyzet e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Të arratisur.

9. Dosje përpunimi nr. 2378, në ngarkim të **P.L.**, me 43 (dyzet e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket ish-Fondit Dega e Punëve të Brendshme Krujë.

10. Fashikull i problemit të centralizuar “Kënetat” nr. 1040, në ngarkim të **B. K.**, me 285 (dyqind e tetëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Dega IV.

11. Dosje gjurmimi nr. 41, në ngarkim të **B.K.**, me 4 volume me 714 (shtatëqind e katërmëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Drejtorja e Punëve të Brendshme Tiranë.

12. Dosje agjenturore nr. 3738 “Kotori”, në ngarkim të **B. K.**, me 312 (treqind e

dymbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Operativ.

13. Dosje përpunimi nr. 2967, në ngarkim të **A.T.**, me 2 volume me 315 (treqind e pesëmbëdhjetë) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Lushnjë.

14. Fashikull nr. 1503, në ngarkim të **Sh.B.**, me 23 (njëzet e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Kosova.

15. Fashikull nr. 1647, në ngarkim të **K.H.**, me 2 volume me 158 (njëqind e pesëdhjetë e tetë) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Drejtorja II.

16. Dosje përpunimi nr. 1394, në ngarkim të **A.I.**, me 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Fier.

17. Dosje personale nr. 4391, në ngarkim të **Dh.K.**, me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Operativ.

18. Dosje formulare nr. 196, në ngarkim të **I.M.**, me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Operativ.

19. Dosje personale dhe pune nr. 245, në ngarkim të **K.L.**, me 414 (katërqind e katërmëdhjetë) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket fondit ish-Operativ.

20. Fashikull nr. 4981, në ngarkim të **T.M.**, me 28 (njëzet e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket fondit ish-Të huajt.

21. Dosje formulare nr. 3846, në ngarkim të **E.M.**, me 24 (njëzet e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Korçë.

22. Dosje formulare nr. 9225, në ngarkim të **S.B.**, me 26 (njëzet e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket fondit ish-Drejtorja e Punëve të Brendshme Tiranë.



23. Dosje përpunimi nr. 573, në ngarkim të **I.K.**, me 51 (pesëdhjetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Krujë.

24. Dosje përpunimi nr. 221, në ngarkim të **V.S.**, me 340 (treqind e dyzet) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Berat.

25. Dosje përpunimi nr. 4835, në ngarkim të **M.K.**, me 208 (dyqind e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket fondit ish-Operativ.

26. Dosje personale nr. 2170, në ngarkim të **M.L.**, me 27 (njëzet e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Dosja i përket fondit ish-Operativ.

27. Dosje përpunimi nr. 2306, në ngarkim të **K.U.**, me 83 (tetëdhjetë e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Krujë.

28. Fashikull personal për të dënuar nr. 154, në ngarkim të **P.K.**, me 24 (njëzet e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Dosja i përket fondit ish-Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

29. Dosje formulare nr. 1267, në ngarkim të **P.K.**, me 3 volume, me 372 fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket fondit ish-Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

30. Dosje formulare nr. 6020, në ngarkim të **P.K.**, me 55 (pesëdhjetë e pesë) + 24 (njëzet e katër) fletë në zarf. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket fondit ish-Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

31. Dosje përpunimi nr. 2452 dhe në brendësi ka fashikull personal për të dënuar, në ngarkim të **S.D.**, me 131 (njëqind e tridhjetë e një) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Fier.

32. Dosje hetimore-gjyqësore nr. 33, në ngarkim të **S.D.**, me 64 (gjashtëdhjetë e katër) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Fier.

33. Dosje formulare nr. 9904 dhe në brendësi ka fashikull personal për të dënuar, në ngarkim të **B.D.**, me 67 (gjashtëdhjetë e shtatë) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket fondit ish-Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

34. Dosje personale dhe pune nr. 2267, në ngarkim të **H.K.**, me 3 volume, me 610 (gjashtëqind e dhjetë) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Dibër.

35. Dosje personale dhe pune nr. 2396, në ngarkim të **A.N.**, me 2 volume, me 124 (njëqind e njëzet e katër) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Dibër.

36. Dosje personale dhe pune nr. 2213, në ngarkim të **H.H.**, me 2 volume, me 63 (gjashtëdhjetë e tre) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Dibër.

37. Dosje personale nr. 1139, në ngarkim të **Xh.M.**, me 48 (dyzet e tetë) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Dibër.

38. Dosje personale dhe pune nr. 2416, në ngarkim të **A.A.**, me 2 volume, me 205 (dyqind e pesë) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Dibër.

39. Dosje agjenturale “Lepuri” nr. 122, në ngarkim të **Sh.N.**, me 5 volume, me 1029 (njëmijë e njëzet e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket fondit ish-Operativ.

KRYETAR I KOMISIONIT TË
DEKLASIFIKIMIT DHE ZHVLERËSIMIT
Gentiana Sula

**KËRKESË****Nr. 3683/6, datë 10.8.2021****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Rikonstruksioni i rrugës ‘Koli Marku’, Patos”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Patos.

Me anë të këtij publikimi kërkohet të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do

të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 3 593 865.59 (tre milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë pikë pesëdhjetë e nëntë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni



Tabela e vlerësimit paraprak për pasuritë, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i rrugës ‘Koli Marku’, Patos”

Nr.	Emër Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. e përgjithshme e truallit në m ²	Sip. e prekur e truallit në m ²	Çmimi për truall (lekë/m ²)	Vlera e truallit	Funksioni i godinës	Sip. e ndërtësës (m ²)	Sip. e prekur e ndërtësës (m ²)	Çmimi njësi/m ² për banesat	Përqindja e amortizimit	Vlera e ndërtësës	Vlera e përgjithshme (lekë)	Gjendja juridike
1	Eduart Dervishi	2890	6/32-ND1	0	0	-	-	Shërbim	35	12.8	-	17.0%	324,530.86	324,530.86	Vërtetim hipotekor
2	Eduart Dervishi	2890	6/32-ND2	0	0	-	-	Shërbim	35	29.2	-	17.0%	740,335.94	740,335.94	Vërtetim hipotekor
3	Arjan Seitaj, Resmije Seitaj	2890	6/50	41	20	2848	56960	Shërbim	38.8	20	-	19.0%	467,071.31	524,031.31	Vërtetim hipotekor
4	Altin Xhafaj	2890	6/49	26	4.1	2848	11676.8	Shërbim	26	4.1	-	19.0%	96,574.51	108,251.31	Vërtetim hipotekor
5	Arben Resulaj, Alveritë Resulaj	2890	6/45	53.7	53.7	2848	152937.6	Shërbim	21.8	21.8	-	13.0%	511,330.58	664,268.18	Vërtetim hipotekor
6	Urani Likaj	2890	4/38+1-3	0	0	-	-	Banim	49	49	28000	0%	1,232,448.00	1,232,448.00	Certifikatë pronësie
													Totali	3,593,865.59	

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 48 lekë